

UDHEZUES PER HARTIMIN E NJE PLANI MESIMOR INDIVIDUAL/ GUIDE TO DEVELOPING AN INDIVIDUAL LEARNING PLAN

Çfarë është një Plan Mësimor Individual (ILP)/ What is the Individual Learning Plan (ILP)?

Plani Mësimor Individual (ILP) është një dokument personal, që nxënësi e harton bashkë me Mësuesit Këshilltarë dhe të tjerë të rritur, që e mbështesin gjatë çdo viti shkollor. Plani "ILP" ka katër seksione:

- Vendosja e Pikësnyimeve
- Përcaktimi i Pengesave Potenciale
- Përcaktimi i Strategjive për Arritjen e Synimeve
- Përgatitje e Listave të Kontrollit të Arritjeve "Checklists" (sipas nivelit të klasës)

Cili është qëllimi i ILP/ What is the purpose of the ILP?

Qëllimi i ILP-së është të ndihmojë nxënësit të jenë vetëkontrollues dhe të marrin përgjegjësitë e arsimimit të tyre. Nxënësit e përdorin ILP-në, për zhvillimin e synimeve të tyre dhe saktësimin e progresit të bërë drejt këtyre synimeve. ILP është një mjet që ndihmon nxënësin, që është në rrugën drejt diplomimit, për të përcaktuar burimet dhe mjetet që duhen, për një drejtim të suksesshëm në jetë.

Si mundësohet dhe përdoret ILP/ How is the ILP accessed and used

Nxënësit kanë akses në ILP-në e tyre, duke u futur në llogarinë e tyre në "StudentNet accounts" (Këshilltarët i ofrojnë fjalëkalimet). Nxënësit krijojnë ILP-në duke futur të dhëna dhe përditësime direkt në ILP-në e tyre, në uebsajtin StudentNet. Mësuesit Këshilltarë, Mësuesit dhe personeli tjetër i shkollës kanë gjithashtu akses në ILP-të, që janë në Schoolnet. Prindërit kanë akses vetëm për të shikuar ILP-në e fëmijës së tyre përmes FamilyNet.

Kush i ndihmon nxënësit për ILP/ Who helps students with the ILP

Mësuesit Këshilltarë, Mësuesit dhe personeli tjetër i shkollës do të punojnë me nxënësit për t'i drejtuar, lehtësuar dhe mbështetur ata në procesin e hartimit të ILP-ve dhe për t'u siguruar që nxënësit kontaktojnë të dhënat në ILP-në e tyre në StudentNet, gjatë fazave kryesore të vitit shkollor.

Prindërit/kujdestarët, si dhe partnerë nga qyteti dhe komuniteti, të cilët punojnë me nxënësit me programe gjatë dhe pas ditës të mësimin, gjithashtu janë të inkurajuar në ndihmën e tyre për të udhëzuar, lehtësuar dhe mbështetur përdorimin nga nxënësit të StudentNet dhe hartimit të ILP-ve.

Si ndërlidhen ILP dhe StudentNet/ How are the ILP and StudentNet related

StudentNet dhe ILP janë projektuar për rritjen e aftësive të nxënësve përmes burimeve të informacionit dhe angazhimit direkt të mësuesve këshilltarë dhe të tjerë të rritur mbështetës, në planifikimin e suksesit të tyre drejt diplomimit dhe më tej.

StudentNet u ofron nxënësve akses në rekordet akademike dhe mjete e burime të tjera të shumta, për hartimin e një ILP-je të vlefshme.

Të dyja, StudentNet dhe ILP janë të vlefshme për të gjithë nxënësit e Drejtorisë Arsimore të klasave K-12. Për vitin shkollor 2010-11, kërkesa është, që të gjithë nxënësit nga klasa e 4^{të} deri në 12^{të}, të zhvillojnë një Plan Mësimor Individual dhe t'a kontaktojnë llogarinë e tyre në StudentNet rregullisht me mbështetjen Këshilltarëve, mësuesve dhe të tjerëve.

Si është formatizuar ILP/How is the ILP formatted

Tre seksionet e para janë formatizuar për përgjigje pa limite në fjalë. Nxënësit mund të shkruajnë sipas dëshirës dhe të futin të dhëna pa kufizim. Listat e Kontrollit të Arritjeve “*checklists*” janë formatuar vetëm për përgjigje me çekim(plotësohet kuadrati).

PERCAKTIMI I SYNIMEVE/SETTING GOALS

Komponenti i përcaktimit të Synimeve të Planit Mësimor Individual (ILP) është shumë i rëndësishëm, sepse ky përcakton bazën për të gjithë pjesët e planit. Nxënësit dhe Këshilltarët nxiten të përdorin kornizën e Synimeve SMART, dhe/ose të tjera, që ofrohen në kurikulën si *Career Choices*, të cilat ndihmojnë nxënësit të zhvillojnë synime të sakta me afat të shkurtër dhe të gjatë. Nxënësit duhet të rishikojnë arritjet e tyre mësimore në StudentNet, të reflektojnë në pikat e forta dhe dobësitë dhe të përfshihen në një diskutim rreth vendosjes të synimeve, që do t'i ndihmojnë ata të arrijnë sukses në afatet e shkurtëra dhe të gjata.

Synimet janë të vlefshme kur ato janë “SMART”: **S**pecifike, të **M**atëshme, të **A**rritshme, **R**ealiste, dhe me afat(**T**imed).

Specifike: Të gjitha synimet që j'u vendosni duhet të jenë shumë të detajuara dhe specifike. Kështu, në vend të thoni “Unë dua të mësoj mirë në klasën e 7-të”, ju duhet të thoni “Unë do të marr vetëm një B+ në të gjitha lëndët e vitit”

Të Matëshme: Synimet SMART janë të matëshme, kështu që do t'a dini kur ato tejkalojnë. Nëse ju luani basketboll, në vend që të thoni “Unë do të bëj shumë pikë këtë sezon” ju duhet të thoni “Unë dua të bëj 150 pikë gjatë këtij sezoni”. Në këtë mënyrë ju do të dini me saktësi kur e arrini synimin tuaj. Ky do të ishte edhe një shembull i një synimi afatshkurtër. Një shembull synimi afatgjatë për basketbollin do të ishte “Unë do të realizoj 1000 pikë deri në diplomimin tim”

Të Arritshme: Synimet tuaja duhet të jenë sfiduese; ne duam që ju të jeni ambicioz. Megjithatë, ato duhet të jenë të arsyeshme. “Unë dua ta mbaroj shkollën e mesme për 2 vjet”, nuk është një synim i arsyeshëm për shumicën e nxënësve të klasës të 9-të. “Unë dua të diplomohem shkëlqyeshëm në Qershor 2013”, është një synim ambicioz, por shumë më i arsyeshëm për nxënësin e klasës të 9-të.

Realiste: Në mënyrë që të jeni të motivuar, synimet tuaja duhet të jenë të rëndësishme për ju. Mendoni seriozisht. Çfarë është e rëndësishme për ju? Çfarë ju vlerësoni? Nëse pasioni juaj është muzika, atëherë vendosni synime, të cilat të çojnë në përmirësimin e talentit tuaj muzikor. Nëse vajtja në kolegji është diçka e rëndësishme për ju, vendosni synime të cilat ju përgatisin për këtë rrugë.

Me afat: Të gjitha synimet tuaja duhet të kenë një datë fillimi dhe një datë përfundimi. Vendosja e synimeve pa përcaktuar afate kohore, mund të çojë në uljen e motivimit për arritjen e tyre. Në vend që të vendosni “unë dua të shkruaj një këngë”, ju duhet që të vendosni një synim, që “do të kompozoni një këngë përpara se të arrini moshën 17 vjeç”.

Vendosja e Synimeve Afatshkurtër dhe Afatgjatë/ Setting Short and Long-Term Goals

ILP do të jetë më e plotë kur nxënësit vendosin synime me afat të shkurtër dhe të gjatë.

Synimet Afatshkurtër fokusohen në vitin aktual shkollor. Mendoni rreth dy lloj synimesh afatshkurtër:

- Synime specifike për mësimin (psh, të përmirësoj notën nga C në B në matematikë, të kryej detyrat e shtëpisë në kohë etj.)
- Synime për sjelljen (psh, të përmirësoj frekuentimin, të eliminoj ardhjet me vonesë, etj.)

Fillimisht, rishikoni rekordet tuaja në StudentNet dhe përcaktoni pikat e forta, dobësitë dhe interesat. Më pas, bazuar në këto rekorde, përcaktoni dhe përshkruani synimet specifike për sukses, arritje dhe përmirësime, të cilat lidhen me lëndët, testet dhe aktivitetet në të cilat do të merrni pjesë gjatë vitit shkollor.

Pas përcaktimit të synimeve tuaja afat shkurtër, i kontrolloni ato regullisht çdo javë dhe përdorni StudentNet për të vlerësuar progresin tuaj. Nëse ju duhet ndihmë për arritjen e një synimi të caktuar, e planifikoni këtë ndihmë. Psh, nëse vendosni si synim marrjen e notës B+ në Algjebra 1, por gjatë kësaj kohe shihet që ju nuk mund ta arrini këtë synim, planifikoni për një tutor, ose takoni mësuesin për konsultim mbas orëve të mësimin. Kontrolli rregullisht i synimeve tuaja do t'ju ndihmojë që ju ti plotësoni ato.

Synimet Afatgjatë fokusohuni në të ardhmen tuaj pas përfundimit të shkollës të mesme.

Fillimisht, rishikoni rekordet tuaja në StudentNet dhe përcaktoni pikat e forta, dobësitë dhe interesat. Më pas, bazuar në këto rekorde, përcaktoni dhe përshkruani synimet specifike për atë që dëshironi të bëni në jetë—menjëherë pas përfundimit të shkollës të mesme dhe më tutje.

Pas përcaktimit të synimeve tuaja afatgjatë, i kontrolloni ato në mënyrë periodike gjatë vitit. Përdorni StudentNet, për të rishikuar rekordet mësimore, duke përfshirë kreditet e akumuluar, notat, frekuentimin, rezultatet e testeve etj. Përcaktoni ecurinë dhe kërkoni ndihmë nëse jeni prapa me afatet dhe rezultatet drejt një synimi të përcaktuar. Rishikimi i synimeve tuaja rregullisht do t'ju ndihmojë që ti arrini ato.

Pyetje që lidhen me Synimet Afatshkurtër: Çfarë duhet të bëj për përmirësimin e rezultatetve mësimore këtë vit shkollor?

Më poshtë janë shembuj synimesh afatshkurtër, të cilat mund t'i përdorni, ose ndryshoni për të krijuar planin tuaj individual mësimor:

Do të kaloj në të gjitha lëndët./ I will pass all of my classes.

Do të rris notën nga ____ në ____ në semestrin e ardhshëm, në lëndën e ____./ I will raise my grade from a ____ to a ____ on the next report card cycle, in ____ class.

Do të marr notën përfundimtare ____ në lëndën e ____ në fund të vitit shkollor./ I will earn a ____ as a final grade in ____ class by the end of the school ____ year.

Do të përmirësoj GPA (Mesatarja e Notave) nga ____ në ____ në fund të vitit shkollor./ I will improve my GPA (Grade Point Average) from a ____ to a ____ by the end of the school year.

Do të diplomohem në shkollën e mesme këtë vit shkollor./ I will graduate high school this year

Do të marr kënaqshëm, ose më mirë, në të gjitha lëndët, që raportohen në dëftesën e shkollës./ I will get a Satisfactory or better in Effort in all of my classes on my report card.

Do të marr kënaqshëm, ose më mirë, në Sjellje, në të gjitha lëndët./ I will get a Satisfactory or better in Behavior in all of my classes.

Do të përmirësoj PSSA në Lexim në Bazë/I aftë/I avancuar./ I will improve my Reading PSSA to Basic/Proficient/Advanced.

Do të përmirësoj PSSA në Matematikë në Bazë/I aftë/I avancuar./ I will improve my Math PSSA to Basic/Proficient/Advanced.

Do të përmirësoj nivelin në Lexim së paku me një shkallë, deri në fund të vitit shkollor./ I will improve my Reading level at least one grade level by the end of the year.

Do të jem në klasë në orar./ I will get to every class on time.

Do të frekuentoj rregullisht shkollën dhe nuk do të mungoj më shumë se një ditë në muaj (me arsye).

Do të bëj të gjitha përpjekjet për të krijuar një klimë të shëndetëshme në klasë dhe në shkollë./ I will attend school regularly and miss no more than one day a month (with good excuse).

Do të angazhohem në aktivitetet jashtë shkollore./ I will do what I can to contribute to a positive climate in my classroom and school.

Do të përmirësoj aftësitë vendimmarrëse dhe do të marr 5 ose më pak /demerit points në muaj.

Të tjera:

Pyetje që lidhen me Synimet Afatgjatë: *Çfarë dua të jem dhe të bëj në jetë, pas mbarimit të shkollës të mesme?*

Më poshtë janë shembuj synimesh, të cilat mund t'i përdorni, për të krijuar planin tuaj individual mësimor afatgjatë:

Synimet e mijë për të ardhmen janë

Synimi/et im/e mia është/janë

Dëshiroj të kthehem në komunitet në mënyrën(at) e / I would like to give back to my community in the following way(s)

Do të ndjek shkollën dy vjeçare/kolegjin pas shkollës të mesme në drejtimin e / I will attend a two-year/four-year college after high school to study and pursue a career in

Do të ndjek karrierën teknike pas shkollës të mesme, në drejtimin e / I will attend a technical school after high school to pursue a career in

Do të shkoj në ushtri, pas shkollës të mesme, për të vazhduar karrierën në / I will join the military after high school to study and pursue a career in

Do të shkoj në punë, pas shkollës të mesme, për të punuar në fushën e / I will enter the workforce after high school to develop a career in the field of

Të tjera:

IDENTIFIKIMI I PENGESAVE POTENCIALE/ IDENTIFYING POTENTIAL BARRIERS

Në këtë seksion të ILP-së, identifikoni pengesat që mund t'ju shmangin në arritjen e synimeve tuaja. Sigurohuni që t'i adresoni pengesat specifike në të dy grupet e synimeve, si ato afatshkurtër dhe ato afatgjatë, në seksionin e Vendosja e Synimeve të ILP.

Pyetje që lidhen me Pengesat në Synimet Afatshkurtër: *Cilat janë sfidat me të cilat do të përballim në arritjen e synimeve afatshkurtër?*

Më poshtë janë shembuj pengesash në synimet afatshkurtër, të cilat mund t'i përdorni, ose ndryshoni për të krijuar planin tuaj individual mësimor:

Nuk i kuptoj kërkesat që duhen për të marrë note kaluese në lëndën(t).

Nuk kuptoj çfarë kërkohet për t'u diplomuar në shkollën e mesme.

Më kërkohet që të plotësoj kreditet në lëndën(t) e _____

Nuk mund ti dëgjoj shpjegimet e mësuesi.

Nuk shikoj qartë çfarë është shkruar në dërrasën e zezë.

Pranë kam një nxënës që më shqetëson gjatë orës së mësimi.

Kam disa detyra familjare, të cilat më pengojnë të jem në kohë në shkollë.

Nuk kam asnjëri në shtëpi, i cili të më ndihmojë në detyrat e shtëpisë.

Shkoj në shtrat shumë vonë, çka më pengon të zgjohem herët në mëngjes.

Nuk kam dijeni për aktivitetet jashtë shkollore, që zhvillohen në shkollën time, ose komunitet.

Shkolla ime fillore/8 vjeçare/e mesme nuk ofron mbështetjen që kam nevojë.

Të tjera:

Pyetje që lidhen me Pengesat në Synimet Afatgjatë: *Cilat janë sfidat me të cilat do të përballim në arritjen e synimeve afatgjatë?*

Më poshtë janë shembuj pengesash në synimet afatgjatë, të cilat mund t'i përdorni, ose ndryshoni për të krijuar planin tuaj individual mësimor:

Nuk kam asnjë pjestar të familjes, i cili të më ndihmojë për procesin e pranimit në kolegji.

Familja nuk mund të më mbështesë financiarisht për të ndjekur kolegjin.

Shokët më bëjnë presion të braktis shkollën.

Shkolla ime fillore/8 vjeçare/e mesme nuk ofron programe mësimi që lidhen me interesat e mija.

Të tjera:

IDENTIFIKIMI I STRATEGJIVE PER ARRITJEN E SYNIMEVE/ IDENTIFYING STRATEGIES TO REACH GOALS

Në këtë seksion të ILP, identifikoni strategjitë për arritjen e synimeve tuaja me afat të shkurtër dhe të gjatë dhe se si ju do t'i kapërceni pengesat e përcaktuara në seksionin e Pengesave Potenciale. Shqyrtoni me sa më shumë detaje specifike. Merrni në konsideratë të gjitha mundësitë e vlefshme në shkollën tuaj, komunitet, qytet, rajon etj. Mund të ketë pengesa të cilat nuk varen nga ju, ose për kapërcimin e të cilave kërkohet ndihma e të tjerëve. Përqëndrohuni në pengesat për të cilat ju MUND të bëni diçka dhe jeni optimist për arritjen e ëndrrave tuaja.

Strategjitë për Arritjen e Synimeve Afatshkurtër: *Çfarë veprime specifike duhet të ndërmarr për arritjen e synimeve afatshkurtër dhe kapërcimin e pengesave në këtë rrugë?*

Më poshtë janë shembuj strategjishë, që lidhen me synimet afatshkurtër, të cilat mund t'i përdorni, ose ndryshoni, për të krijuar planin tuaj individual mësimor

Do të bisedoj me mësuesin(t) për kërkesat që duhen për të marrë notë kaluese.

Do të kontrolloj në StudentNet, politikën e Drejtorisë Arsimore të Filadelfias për diplomimin dhe mbështetjen e nxënësve.

Do të rikuperoj deficietet e krediteve duke u regjistruar në programe që plotësojnë këto boshllëqe.

Do të lexoj për kënaqësinë time në shtëpi, gjatë 4 ose më shumë ditëve në javë.

Do të bëj detyrat e shtëpisë dhe do ti plotësoj ato së paku 80% në kohë.

Do të kërkoj ndihmë, nëse nuk kuptoj diçka.

Do të ndihmoj nxënësit e tjerë nëse kanë nevojë për ndihmë.

Do të kërkoj të çvendosem në një bankë më afër dërrasës së zezë.

Do të bisedoj me mësuesin për t'u çvendosur në një bankë tjetër, që të mos shqetësohem nga nxënësit e tjerë.

Do të takoj infermieren e shkollës për një kontroll të syve/veshëve.

Do të studjoj për çdo test, ose kuiz së paku ½ orë.

Do të ngre dorën për përgjigje së paku një herë në javë, kur e di përgjigjen e pyetjes të mësuesit.

Do të marr informacion (Nga këshilltari, mësuesi, StudentNet, etj.), si edhe do të bëj hapat e nevojshme për të marrë pjesë në aktivitetet jashtëshkollore, që do të më ndihmojnë për të mësuar gjëra të reja.

Do të përdor orën me zile, ose do të gjej forma të tjera, që të ngrihem në kohë dhe të mos vonohem për vajtjen në shkollë.

Do të bisedoj me mësuesin këshilltar rreth burimeve dhe mbështetjeve, që janë të mundëshme për familjen time.

Do të përdor StudentNet-in dhe/ose kujdestar mbas shkollës.

Do të ndërmarr hapat në vazhdim për të frekuentuar rregullisht në kohë shkollën (shiko Kontratën për Eliminimin e Mungesave dhe Largimeve nga Shkolla)

Do të përdor StudentNet dhe do të kontaktoj Qendrën e Ri-Angazhimit, për të gjetur shkollën, që më ofron mundësitë më të mira për përfundimin e shkollës së mesme, ndërsa punoj dhe/ose kujdesem për fëmijët.

Do të kërkoj të transferohem në një shkollë filllore/8 vjeçare/të mesme, e cila më ofron mbështetjen për të cilën unë kam nevojë.

Të tjera:

Strategjitë për Arritjen e Synimeve Afatgjatë: Çfarë veprime specifike duhet të ndërmerret për arritjen e synimeve afatgjatë dhe kapërcimin e pengesave në këtë rrugë?

Më poshtë janë shembuj strategjishë që lidhen me synimet afatgjatë, të cilat mund t'i përdorni, ose ndryshoni, për të krijuar planin tuaj individual mësimor:

Do të kërkoj dhe gjej shkollat, që janë më të përshtatëshme për mua.

Do të bëj hapat e duhura për të aplikuar në shkollat filllore/8 vjeçare/të mesme me zgjedhje

Do të kërkoj të transferohem në një shkollë, programi i të cilës përkon me interesat e mija.

Do të përpiqem të gjej një të rritur, i cili do të shërbejë si Drejtues për Diplomimin, duke më dhënë mbështetje për arritjet e mija mësimore (shikoni www.phillygradcoach.org)

Do të marr përsipër sfida mësimore, duke marrë klasa të Avancuara (AP) dhe/ose klasa me Regjistrim të Dyfishtë, në mënyrë që të fitoj kredite shtesë, për në klasat e kolegjit.

Do të marr përsipër sfida mësimore, duke marrë klasa të avancuara (kalkulus, Fizikë, Spanjisht 4, etj).

Do të marr pjesë në një program drejtimi.

Do të kërkoj ndihmë për përmirësimin e aftësive të mija studimore.

Do të kërkoj së paku tre drejtime kariere të ndryshme dhe do të përcaktoj kërkesat mësimore, që kërkohen nga secila.

Do të identifikoj profesionistët në fushat që po hulumtoj dhe do të përpiqem të takohem dhe bisedoj me ta, për të mësuar më shumë rreth këtyre profesioneve.

Do të shqyrtoj mundësitë për të shkuar në kolegji pas përfundimit të shkollës së mesme..

Do të shqyrtoj mundësitë për të filluar një karrierë pas shkollës së mesme, si psh. përmes një pune në nivelin fillestar, nxënës në profesion, stazhier, shërbim civil, etj.

Do të shqyrtoj mundësitë për të marrë arsim përmes ushtrisë.

Do të ndjek seminarin financiar, për të mësuar se si ta përballoj financiarisht kolegjin.

Do të përdor "Scholarship Clearinghouse", për të mësuar rreth granteve dhe bursave që ofrohen.

Do të plotësoj kërkesat e FAFSA –s në mënyrë që të kualifikohem për ndihmën financiare për ndjekjen e kolegjit.

Të tjera:

LISTAT E PERGATITJES PER SUKSES

Ky seksion ofron një seri lista kontrolli, që ndahen sipas nivelit të klasave, fokusohen në hapat e veprimit që nxënësit mund të ndërmarrin me ndihmën e familjeve të tyre, shkollës dhe komunitetit, për të hedhur bazat e suksesit të tyre. Qëllimi i këtyre listave të kontrollit është sigurimi që fushat me përparësi dhe vendimet kryesore janë gjithnjë në “radarin” e nxënësit

Ky seksion i ILP-së është formatuar për përgjigje që bëhen me plotësim kuadratesh. Nëse është e nevojshme, përgjigje më të detajuara mund të ofrohen në seksionet e tjera të ILP. Nxënësit duhet të shqyrtojnë dhe të përgjigjen për të çështjet që korespondojnë me klasën e tyre. Nxënësit mund t'i rishikojnë përgjigjet e tyre në çdo kohë.

FILLORE (K-5)

Unë marr pjesë në aktivitetet jashtëshkollore që fokusohen në (plotësoni të gjitha që aplikohen):

- Atletikë/ Athletics
- Arritje Akademike / Academics
- Arte /Arts
- Shërbim në Komunitet / Community Service
- Zhvillimi i aftësive drejtuese/ Leadership Development
- Të tjera/ Other
- Nuk marr pjesë në asnjë aktivitet/ None
- Do të bisedoj me mësuesin këshilltar dhe të tjerë, si edhe do të vizitoj StudentNet, për të zbuluar çfarë aktivitetesh janë të vlefshme/ I will talk to my Counselor and others, and will visit StudentNet, to find out what extracurricular activities are available

Si jam duke qëndruar në rrugën e duhur (plotësoni të gjitha që aplikohen):

- Mësime me tutor pas shkollës/ After-school tutoring
- Ndjek shkollën e verës për ecje më përpara/ Attending summer school for promotion
- Ndjek shkollën e verës për pasurim dijesh/ Attending summer school for enrichment
- Lexoj në mënyrë të pavarur/ Reading on my own
- Rishikoj regullisht ILP për të kontrolluar progresin, përcaktuar nëse kam nevojë për ndihmë dhe bëj përditësime nqs janë të nevojshme/ Reviewing my ILP regularly to check progress, determine if I need help, and make updates if necessary
- Të tjera/ Other

Hapat e tjera pas mbarimit të shkollës të mesme (plotësoni të gjitha që aplikohen):

- Kolegj / College
- Shkollë teknike/ Technical school
- Ushtri/Military
- Punësim/ Employment
- Të tjera Other

Tetëvjeçare (6-8)

Marr pjesë në aktivitete jashtëshkollore që fokusohen në (plotësoni të gjitha që aplikohen):

- Atletikë/ Arritje Akademike/ Athletics Academics
- Arte/ Arts
- Shërbim në Komunitet/ Community Service
- Zhvillimi i aftësive drejtuese / Leadership Development
- Të tjera/ Other
- Nuk marr pjesë në asnjë aktivitet/ None
- Do të bisedoj me mësuesin këshilltar dhe të tjerë, si edhe do të vizitoj StudentNet, për të zbuluar çfarë aktivitete jashtëshkollore janë të vlefshme/ I will talk to my Counselor and others, and will visit StudentNet, to find out what extracurricular activities are available

Si jam duke qëndruar në rrugën e duhur (plotësoni të gjitha që aplikohen):

- Mësim me tutor pas shkollës/ After-school tutoring
- Ndjek shkollën e verës për ecje më përpara/ Attending summer school for promotion
- Ndjek shkollën e verës për pasurim dijesh/ Attending summer school for enrichment
- Lexoj në mënyrë të pavarur/ Reading on my own
- Vizitoj StudentNet regullisht për rishikimin e arritjeve dhe për të mësuar më tepër/ Visiting StudentNet regularly to review my academic record and explore other resources
- Rishikoj regullisht ILP për të kontrolluar progresin, përcaktuar nëse kam nevojë për ndihmë dhe bëj përditësime n.q.s janë të nevojshme/ Reviewing my ILP regularly to check progress, determine if I need help, and make updates if necessary
- Të tjera/ Other

Plani im është të ndjek shkollën e mesme, që është (plotësoni të gjitha që aplikohen):

- Shkollë e lagjes/ Neighborhood
- Shkollë e lagjes(në zonë tjetër)/ Neighborhood (in another zone)
- Me pranim nga gjithë qyteti/ Citywide Admission
- Me pranim special / Special Admission
- Çartër/ Charter
- Fetare/ Parochial
- Shkollim në shtëpi/ Home schooling
- Të tjera/ Other
- Nuk e di, por do të kërkoj ndihmë nga mësuesi këshilltar dhe të tjerë, si dhe do të vizitoj StudentNet , për të kërkuar shkollat e Drejtorisë Arsimore/ Don't know yet, visit StudentNet , to ask for help from the counselor and others, and visit StudentNet , to ask for help from the Director of Education

but will seek help from my Counselor and others, and will visit StudentNet to research District schools

Hapat e tjera pas mbarimit të shkollës të mesme (plotësoni të gjitha që aplikohen):

- Kolegj / College
- Shkollë teknike/ Technical school
- Ushtri/ Military
- Punësim/ Employment
- Të tjera/ Other

HIGH SCHOOL (9-12)

Unë do të mund të diplomohem

- Në mes të vitit shkollor (Shkurt)/ Mid-year (February)
- Në fund të vitit shkollor (Qershor)/ At the end of this school year (June)
- Në fund të shkollës së verës (Korrik)/ At the end of summer school (July)
- Në dy vjet/ In two years
- Në tre vjet/ In three years
- Në katër vjet/ In four years
- Në më shumë se katër vjet/ In more than four years
- Nuk jam i sigurtë dhe do të kërkoj ndihmë nga mësuesi këshilltar/ Not sure and will seek help from my Counselor

Si jam duke qëndruar në rrugën e duhur (plotësoni të gjitha që aplikohen):

- Mësim me tutor pas shkollës/ After-school tutoring
- Ndjek shkollën e verës për ecje më përpara/ Attending summer school for promotion
- Ndjek shkollën e verës për pasurim dijesh/ Attending summer school for enrichment
- Lexoj në mënyrë të pavarur/ Reading on my own
- Vizitoj StudentNet rregullisht për rishikimin e arritjeve dhe për të mësuar më tepër/ Visiting StudentNet regularly to review my academic record and explore other resources
- Rishikoj rregullisht ILP për të kontrolluar progresin, përcaktuar nëse kam nevojë për ndihmë dhe bëj përditësime nqs janë të nevojshme/ Reviewing my ILP regularly to check progress, determine if I need help, and make updates if necessary
- Punoj me një Drejtues Diplomimi, që më ofron kujdestari dhe mbështetje për suksesin tim mësimor (shiko www.phillygradcoach.org)/ Working with a Graduation Coach to provide mentorship and support for my academic success (see www.phillygradcoach.org)
- Të tjera/ Other

Marr pjesë në aktivitete jashtëshkollore që fokusohen në (plotësoni të gjitha që aplikohen):

- Atletikë / Athletics

- Arritje Akademike / Academics
- Arte/ Arts
- Shërbim në Komunitet/ Community Service
- Zhvillimi i aftësive drejtuese/ Leadership Development
- Punë me orar të pjesëshëm/ Part-time Job
- Të tjera/ Other
- Nuk marr pjesë në asnjë aktivitet/ None
- Do të bisedoj me mësuesin këshilltar dhe të tjerë, si edhe do të vizitoj StudentNet, për të zbuluar çfarë aktivitete janë të vlefshme/ I will talk to my Counselor and others, and will visit StudentNet, to find out what extracurricular activities are available

Do të ndjek një rrugë tjetër për diplomimin nga shkolla e mesme (plotësoni të gjitha që aplikohen, ose plotësoni kutinë e fundit nëse asnjë nuk aplikohet):

- Shkollë e mesme e përshpejtuar/ Accelerated High School
- Programi GED/ GED Program
- Gateway to College/ Gateway to College
- Educational Options Program (EOP) / Educational Options Program (EOP)
- Programi Oasis/ Oasis Program
- Të tjera/ Other
- Do të bisedoj me mësuesin këshilltar dhe/ ose do të vizitoj Qendrën e Ri-angazhimit për të zbuluar opsione të mundshme që u përshtaten më mirë nevojave të mija/ I will talk to my Counselor and/or visit a District Re-Engagement Center to find out what options are available and best suited to my needs
- NUK do të ndjek rrugë tjetër për diplomim/ I will NOT take an alternative pathway to graduation

Hapat e tjera pas mbarimit të shkollës të mesme (plotësoni të gjitha që aplikohen):

- Kolegj (Dy vite)/ College (two-year)
- Kolegj (Katër vite)/ College (four-year)
- Shkollë teknike/ Technical school
- Ushtri/ Military
 - Shërbim civil/ Civil Service
- Praktikant/Apprenticeship
 - Nxënës stazhier/ Internship
 - Program shërbimi (City Year, etj.)/ Service program (City Year, etc.)
 - I punësuar/ Employment
 - Të tjera/ Other
- Akoma nuk kam vendosur, por do të kërkoj ndihmë nga mësuesi këshilltar dhe të tjerët, si dhe do të vizitoj StudentNet, të mësoj më shumë/ Don't know yet, but will seek help from my Counselor and others, and will visit StudentNet to learn more

Hapat që kam ndërmarrë, për të paguar studimet pas shkollës së mesme (plotësoni të gjitha që aplikohen):

- Kam marrë pjesë në seminare për ndihmë financiare/ Participated in a financial aid workshop
- Kam plotësuar FAFSA-n (Aplikim falas për Ndihmën Federale për Studentin)/ Completed the FAFSA (Free Application for Federal Student Aid)

- Kam përdorur rrjetet e Drejtorisë Arsimore Clearinghouse dhe StudentNet për të kërkuar mundësitë për bursat dhe grantet / Used the School District's Scholarship Clearinghouse and StudentNet to research scholarship and grant opportunities
- Kam plotësuar aplikime për të marrë bursa dhe grante/ Submitted applications for scholarship and grant awards
- Akoma nuk kam ndërmarrë ndonjë hap të mësipërm, por do të kërkoj ndihmë nga mësuesi këshilltar dhe të tjerët, si dhe do të vizitoj StudentNet, të mësoj më shumë/ Not yet taken any of these steps, but will seek help from my Counselor and others, and will visit StudentNet to learn more

Hapat që kam ndërmarrë, që të mësoj për rrugët e mëtejshme drejt kolegjit apo të karrierës së (plotësoni të gjitha që aplikohen):

- Kam vizituar kampuse të kolegjit(ve) dy dhe/ose katër- vjeçar/ Visited the campus of two and/or four-year college(s)
- Kam vizituar kampuse të shkollave të akredituara teknike/ Visited the campus of accredited technical schools
- Kam hulumtuar së paku tre kolegje ose universitete/ Researched at least three colleges or universities
- Kam marrë pjesë në një/Participated in a job shadowing day
- Kam marrë pjesë në një panair kariere/ Participated in a career fair
- Kam hulumtuar së paku tre kariera të ndryshme dhe arsimimin/trejnimin e kërkuar për të qënë i suksesshëm në sejcilën prej tyre/ Researched at least three different careers and the education/training needed for success in each
- Kam folur me profesionistë në fushat që jam i interesuar/ Spoken with professionals in the careers I am interested in
- Kam punuar gjatë verës dhe/ose në punë të pjesëshme pas orarit të shkollës/ Worked in a summer and/or part-time job after school
- Kam kryer një program stazhieri në punë/ Completed an internship program
- Akoma nuk kam ndërmarrë ndonjë hap të mësipërm, por do të kërkoj ndihmë nga mësuesi këshilltar dhe të tjerët, si dhe do të vizitoj StudentNet, të mësoj më shumë/ Not yet taken any of these steps, but will seek help from my Counselor and others, and will visit StudentNet to learn more

Provimet pas shkollës së mesme që kam marrë (plotësoni të gjitha që aplikohen):

- PSAT / PSAT
- SAT/ SAT
- ACT/ ACT
- NOCTI (për nxënësit e edukimit teknik dhe profesional)/ NOCTI (for Career and Technical Education students)
- Nuk kam marrë akoma provimet, por do të pyes mësuesin këshilltar dhe të tjerët, si dhe do të vizitoj StudentNet, që të mësoj më shumë /
- No exams yet taken, but will ask my Counselor and others for information, and will visit StudentNet to learn more

Klasat që kam marrë për kredite shtesë/kolegji (plotësoni të gjitha që aplikohen):

- Klasa të avancuara/ Advanced Placement
- Regjistrim i dyfishtë/ Dual Enrollment
- Diplomë ndërkombëtare/ International Baccalaureate
- Shkollë vere në kampuset e kolegjeve/ Summer enrollment on college campus
- Nuk kam marrë klasa për kredite shtesë/ No college credit-bearing courses taken

- Nuk kam marrë akoma klasa të tilla, por do të pyes mësuesin këshilltar dhe të tjerët, si dhe do të vizitoj StudentNet, të mësoj më shumë/
- No courses yet taken, but will ask my Counselor and others for information, and will visit StudentNet to learn more

Klasat që kam marrë për pranim në shkollë dhe/ose punësim (plotësoni të gjitha që aplikohen):

- Kam aplikuar për pranim në një radhë kolegësh dhe universitetesh, që mendoj se më përshtaten mua/ Applied for admission to a range of colleges and universities that are a good fit for me
- Kam aplikuar për pranim në një shkollë teknike, që i përshtatet interesave të mia për karrierë/ Applied for admission to technical school(s) that fit my career interests
- Kam aplikuar për mundësi punësimi të tilla si, stazhier, nxënës në profesion, shërbim civil, programe për shërbime në komunitet/ Applied for employment opportunities such as an apprenticeship, internship, civil service, community service programs
- Kam aplikuar për pranim në ushtri / Applied for admission to the military
- Nuk kam bërë akoma aplikime, por do të kërkoj ndihmë nga mësuesi këshilltar dhe të tjerët / No applications made yet, but will seek help from my Counselor and others
- Është shumë shpejt për të bërë aplikime (nxënësit e klasave 9-11)/ It is too early to make applications (students in grades 9-11)

PUNA E NXENESIT/VLERESIME TE TJERA/ STUDENT WORK/OTHER EVALUATIONS

Ky seksion ofron një vend për nxënësit që ngarkojnë dokumente, të cilat janë të lidhura me synimet dhe planet e tyre. Çdo lloj materiali mund të ngarkohet në një hapësirë deri 1 MB për nxënës në vit. Për të rritur hapësirën e nevojshme, shumë materiale (veçanërisht ato që janë pjesë e një dosje, ose lidhen me një projekt të vetëm) mund të ngjeshen dhe të ruhen sëbashku si materiale në formë “zip”.

Këtu po japim disa shembuj të materialeve që nxënësit mund të duan, që ti ngarkojnë në këtë seksion të ILP:

- Pjesë personale shkrimi/eseje të shkruara për aplikime bursash dhe kolegji /Personal statement/essay written for scholarship and college applications
- Shembuj të një pune të veçantë, që dëshiron të përfshihet në dosjen personale, projekt mësimor dhe/ose projekt mature/ Samples of exemplary work for inclusion in a portfolio, service learning project, and/or a senior project
- Fotografi dhe klipe filmike të projekteve në artet e aplikuar/ Photos and film clips of performing arts projects
- Kontrata për Frekuentimin dhe Eleminimin e Mungesave pa Arsye/ An Attendance and Truancy Elimination Contract